

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk

Sot me date 17.08.2006 (dymije e gjashte) ,diten e Enjte , ne ortaket :

1. *Napolon Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 03.10.1955, ne Himare e banues ne Himare .
2. *Jani Rapo* , i biri i Aristotel , lindur me 15.07.1980, ne Fier e banues ne Himare .
3. *Pano Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 11.08.1951, ne Vlore e banues ne lagjen ,, Liri Gero ,, Fier
4. *Thanas Rapo* , i biri i Pano , lindur me 25.07.1979, ne Himare Vlore e banues ne Himare Vlore .
5. *Aristotel Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 07.10.1949, ne Himare e banues ne Himare ..., bazuar ne legjislacionin shqiptar Vendosem :

Neni 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqerine « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk » e krijoj sipas llojit Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar duke e emertuar « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk

Neni 2

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqeria « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 20 vjet .Me vendim te asamblese se ortakeve ky afat mund te jete me i shkurter apo mund te zgjatet me tej

Neni 3

QENDRA (SELIA)


Shoqeria « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk do te kete qendren (seline) e saj ne adresen Himare Vlore .

Shoqeria ka te drejte te hapi degë dhe te zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk është si më poshtë:



- Eksport - importin dhe tregëtimin me shumice dhe pakice, të mallrave industrial dhe ushqimore ,elektroshtepiake ,makina ,hapje të serviseve të ndryshme ,makineri e pajisje të ndryshme ,materialeve të ndertimit, hidrosanitare , pajisjeve dhe sistemeve informatike dhe mirembajtja e tyre ,hapje e linjave të ndryshme të prodhimit ,
- Ngjitje dhe administrim i bareve ,restoranteve ,hotelerive ,si dhe aktivitete të tjera ndihmese të ndërvarrura apo në funksion të aktivitetit të mesiperm .
- Aktivitet në fushën e transportit dhe speditonit për vetë dhe për llogari të tjetër .

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë edhe gjithë ato aktivitete të cilat në mënyrë direkte apo indirekte përpunohen me objektin e mësipërm.

Neni 5

REGJIMI JURIDIK.

Në të gjithë territorin e saj në Republikën e Shqipërisë Shoqëria do të udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar në fuqi

Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë dhe të ortakut të vetëm të saj përcaktohen me hollësisht në Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plote në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Për evidentimin e veprimtarisë së Shoqërisë do të përdoren dispozitat ligjore në fuqi, dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit ,siç sqarohet me hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqatës.

Shoqëria gëzon afirmimin ligjor që nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë .

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISE

6/1 Kapitali bazë i Shoqërisë është :

Në para – 100.000 lek, e barabartë me 100 kuota ,teresisht prone e ortakëve themelues Kontributet e ortakëve themelues në Kapitalin Themeltar janë:

- Napolon Rapo 20000 Lek (20% të kuotave të kapitalit)
- Pano Rapo 20000 Lek (20% të kuotave të kapitalit)
- Aristotel Rapo 20000 Lek (20% të kuotave të kapitalit)
- Thanas Rapo 20000 Lek (20% të kuotave të kapitalit)
- Jani Rapo 20000 Lek (20% të kuotave të kapitalit)

të depozituar në Banka Popullore , dega Himarë ,në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi



6/2 Kapitali i shoqerise do te ritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe te vendimeve qe do te marrim ne ortaket per ta rritur ate ne te ardhmen.

6/3 Ne rast vdekje te njerit prej ortakeve pasuria u kalon trashegimtareve te sejcilit prej tyre sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

Neni 7

DREJTIMI I SHOQERISE

7/1 Fillimisht Shoqeria do te udhëhiqet, administrohet dhe drejtohet nga Administratori i shoqerise qe do te jene z. Thanas Rapo i cili do te paraqesoje shoqerine edhe ne maredhenjet me te tretet .

7/3 Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise do te vendosim zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik .

7/4 Per cdo ceshtje profesionale ,si juridike ,ekonomike ,teknike etj ,shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar spacialist sipas legjislacionit ne fuqi .

Neni 8

SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE

8/1 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi

8/2 Pasuria qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Asambleja e ortakeve .

Neni 9

LIKUJDIMI I SHOQERISE


Rastet dhe likujdimi I Shoqerise si dhe ajo e mbarimit te afatit te Aktit te Themelimit te Shoqerise ,do te jene ato qe pasqyrohen ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

10/1 Ky akt per themelimin e Shoqerise ka si pjese te saj edhe Statutin e Shoqerise I cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

10/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruar edhe ky Akt - Themelimi .

10/3 Adresa ligjore e shoqerise eshte : Himare Vlore



10/4 Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim ,te nenshkruhet nga ne Ortaket e saj dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj,ashtu edhe ne gjykatën e Rrethit Tirane. . Ky akt themelimi i shoqerise u printua ne pese kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga une ortaket e saj me vullnet te lire dhe te plote .

Pano Rapo
CFT

ARISTOTEL RAPO
NAPOLON RAPO
Jani Rapo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE
NOTERE SAIMIRA HOXHA

VLQRE me 17.08.2006
Rep. 1334
Kol/744

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 17.08.2006 u paraqiten para meje Noteres se rrethit VLORE ,Saimira Hoxha ,personalisht shtetasi shqiptare :

1. *Napolon Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 03.10.1955, ne Himare e banues ne Himare . I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit une jam bindur nga Pasaporta Z1594858.
2. *Pano Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 11.08.1951, ne Vlore e banues ne lagjen ,, Liri Gero ,, Fier.I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit une jam bindur nga Pasaporta me Nr Z0512535.
3. *Aristotel Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 07.10.1949, ne Himare e banues ne Himare . I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit une jam bindur nga Pasaporta me Nr Z1503175.
4. *Thanas Rapo* , i biri i Pano , lindur me 25.07.1979, ne Himare e banues ne Himare . I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit une jam bindur nga Pasaporta me Nr Z0011564.
5. *Jani Rapo* , i biri i Aristotel , lindur me 15.07.1980, ne Fier e banues ne Himare . I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit une jam bindur nga Pasaporta me Nr Z1671053.

Te cilet me vullnet te lire dhe me deshiren e plote te tyre nenshkruan kete Akt Themelimi per krijimin e Shoqerise « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk .

Une Noterja pasi e gjej aktin e sipershenuar konform vullnetit te kerkuesve e legalizoj ate dhe e vertetoj rregullisht konform ligjit .

NOTERE
SAIMIRA HOXHA



STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk

- Sot me date 17.08.2006 (dymije e gjashte) ,diten e Enjte , ne ortaket :
1. *Napolon Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 03.10.1955, ne Himare e banues ne Himare .
 2. *Jani Rapo* , i biri i Aristotel , lindur me 15.07.1980, ne Fier e banues ne Himare .
 3. *Pano Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 11.08.1951, ne Vlore e banues ne lagjen ,, Liri Gero ,, Fier
 4. *Thanas Rapo* , i biri i Pano , lindur me 25.07.1979, ne Himare Vlore e banues ne Himare Vlore .
 5. *Aristotel Rapo* , i biri i Nasho , lindur me 07.10.1949, ne Himare e banues ne Himare .., bazuar ne legjislacionin shqiptar Vendosem :

Neni 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqerine « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk e krijoj sipas llojit Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar duke e emertuar « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk

Neni 2

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqeria « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 20 vjet .Me vendim te asamblese se ortakeve te vetem ky afat mund te jete me i shkurter apo mund te zgjatet me tej

Neni 3

QENDRA (SELIA)

Shoqeria « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk do te kete qendren (seline) e saj ne adresen Himare . .

Shoqeria ka te drejte te hapi degë dhe te zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.


Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk është si më poshtë:

Eksport - importin dhe tregtimin me shumice dhe pakice, te mallrave industrial dhe ushqimore ,elektroshtepiake ,makina ,hapje te serviseve te ndryshem ,makineri e paisje te ndryshme ,materialeve te ndertimit , hidrosanitare , paisjeve dhe sistemeve informatike dhe mirembajtaja e tyre ,hapje e linjave te ndryshme te prodhimit ,

Ngjitje dhe administrim i bareve ,restoranteve ,hotelerive ,si dhe aktivitete te tjera ndihmese te ndervarura apo ne funksion te aktivitetit te mesiperm .



Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë edhe gjithë ato aktivitete të cilat në mënyrë direkte apo indirekte përputhen me objektin e mësipërm.

Neni 5

REGJIMI JURIDIK.

Ne te gjithë teritorin e saj ne Republiken e Shqiperise Shoqeria do te udhehiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi, dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit ,sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise

Shoqeria gezon afirmimin ligjor qe nga dita e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane .

Neni 6

KAPITALI I SHOQERISE

6/1 Kapitali baze i Shoqerise eshte :

a :- Ne para - 100.000 lek, e barabarte me 100 kuota ,teresisht prone e ortakeve themelues Kontributet e ortakëve themelues në Kapitalin Themeltar janë:

- Napolon Rapo 20000 Lek (20% te kuotave te kapitalit)
- Pano Rapo 20000 Lek (20% te kuotave te kapitalit)
- Aristotel Rapo 20000 Lek (20% te kuotave te kapitalit)
- Thanas Rapo 20000 Lek (20% te kuotave te kapitalit)
- Jani Rapo 20000 Lek (20% te kuotave te kapitalit)

te depozituar ne Banka Popullore , dega Himare ,ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi

6/2 Kapitali i shoqerise do te ritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe te vendimeve qe do te marrim ne ortakët per ta rritur ate ne te ardhmen.

6/3 Kapitali i Shoqërisë Tregtare mund të shtohet ose pakësohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Ne rast vdekje te njerit prej ortakeve pasuria u kalon trashegimtareve te sejcilit prej tyre sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Në rast zmadhimi të kapitalit fillestar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nëshkrimin përpjestimisht me kuotën e tyre në formimin e kapitalit themelor, por janë të lirë të heqin dorë nga një e drejtë e tillë. Në asnjë rast nje ortak nuk mund të detyrojë ortakun tjeter për të rritur detyrimin e tij në kapitalin e Shoqërisë.


Në rast zvogëlimi të kapitalit, preken kuotat e secilit ortak në mënyrë përpjestimore me kontributin në Kapitalin Themeltar.

Neni 7

DREJTIMI I SHOQERISE

7/1 Fillimisht Shoqeria do te udhehiqet, administrohet dhe drejtohet nga Administratori i shoqerise qe do te jete z. Thanas Rapo , i cili do te paraqesoje shoqerine edhe ne maredhenjet me te tretet.

7/3 Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise do te vendosim zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik .



7/4 Per cdo ceshtje profesionale ,si juridike ,ekonomike ,teknike etj ,shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar spacialist sipas legjislacionit ne fuqi .

Neni 8

ORTAKËT DHE MBLEDHJA E ORTAKËVE

- Asambleja e Shoqërisë Tregëtare „ RAPO'S RESORT HOTEL ” shpk është organi më i lartë i saj dhe përbëhet prej ortakëve themelues të shoqërisë.
- Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me përqindjen e kapitalit individual në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- Asambleja e Shoqërisë përcakton e miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj, emëron, zgjedh e shkarkon administratorin etj.
- Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Vendimet e Asamblesë mund të merren edhe nëpërmjet konsultimit me shkrim, nëse një nga ortakët nuk merr pjesë në mbledhjen e Asamblesë.
- Për çdo çështje të shqyrtuar nga ortakët mbahet proces-verbal në një regjistër të veçantë.Vendimet e Asamblesë nënshkruhen nga të pranishmit.
- Asambleja zhvillon mbledhje të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Mbledhja e Zakonshme vendos emërimin apo shkarkimin e administratorit, dhe likuiduesve, miratimin e raporteve të administrimit, miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimive.
- Mbledhjet e Zakonshme duhet të thirren të paktën dy herë në vit, duke lajmëruar me shkrim ortakët të paktën 15 ditë përpara për kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes.
- Në Mbledhjet e Jashtëzakonshme shqyrtohet dhe vendoset për çështje të tilla si krijimi, bashkimi, ndarja, shpërbërja e Shoqërisë, ndryshime në statutin e saj dhe probleme të tjera të rëndësishme themelore për të cilat kërkohet miratim me $\frac{3}{4}$ e votave.
- Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

Neni 9

Në ushtrimin e së drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimet kolektive, çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet vetë ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij me shkrim.


Neni 10

Asambleja e Shoqërisë Tregëtare « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk drejtohet nga Administratori i Përgjithshëm i saj. Ortakët kanë zgjedhur sit ë tillë Z.Thanas

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 11

Shoqëria Tregëtare « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk deklarohet e krijuar në zbatim të plotë normave që përmban ky Statut dhe ato të legjislacionit shqiptar në fuqi,



Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë, si person juridik, ndërsa e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin si subjekt privat në Zyrën e Tatimeve Vlore. Emërtimi i Shoqërisë dhe emri i Administratorit të Përgjithshëm të saj duhet të figurojë në të gjithë dokumentet e nxjerra prej saj dhe që iu drejtohen të tretëve.

Neni 12

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje Shoqëria « RAPO'S RESORT HOTEL » shpk . Ajo ka llogarinë e saj në lekë dhe valutë në Banken Popullore ,,

Neni 13


Vendimet për çështjet e mëposhtme janë kompetencë e Asamblesë dhe merren me shumicë votash, përveç rasteve të përcaktuara me 2/3:

- a. Përcaktimi i strukturës organizative të brendshme të Shoqërisë.
- b. Kriteret e përgjithshme për punësimin e personave të tjerë, numrin e tyre, kufijtë e pagesës dhe detyrat e secilit në Shoqëri përcaktohen nga Mbledhja e Asamblesë.
- c. Miratimi i aktivitetit të Shoqërisë dhe i bilancit financiar të saj. Përcaktimi dhe miratimi i planit persepektiv dhe strategjisë së zhvillimit.
- d. Miratimi i planit të investimeve për shuma që tejkalojnë 5% të totalit të të ardhurave të Shoqërisë për vitin fiskal paraardhës.
- e. Përcaktimi i formës së gjithë dokumentacionit të Shoqërisë, letrave të saj me vlerë, etj.
- f. Krijimi ndërmarrjeve të përbashkëta, fuzionimin e të tjera të këtij lloji.
- g. Caktimi i kontrollorëve dhe i shpërblimit të tyre.
- h. Amendamentet në dokumentat bazë të Shoqërisë. (statute, kontrata dhe rregullorja e brendshme).
- i. Caktimi i kompetencave të Administratorit të Përgjithshëm.
- j. Modifikimi i përqindjeve të partnerëve në Kapitalin e Shoqërisë me kërkesën me shkrim të Partnerit.
- k. Likuidimi i Shoqërisë.

Neni 14

Administratori i Përgjithshëm ushtron veprimtarinë e tij ndërmjet dy mbledhjeve të Asamblesë dhe ka këto kompetenca dhe detyra:

- a. Të zbatoj planin e zhvillimit, të investimeve dhe gjithë orientimet e Asamblesë së Partnerëve.
- b. Të respektoj e ndjekin aplikimin e marrëveshjeve të Shoqërisë.
- c. Të organizoj mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Shoqërisë.
- d. T'i jap llogari Mbledhjes për aktivitetin e tij dhe rezultatet e Shoqërisë në periudhën ndërmjet dy mbledhjeve të Asamblesë.
- e. Të punësoj punonjësit mbi bazën e kontratës individuale të punës të hartuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- f. Të bëj investime për shuma deri në 5% të totalit të të ardhurave të Shoqërisë për vitin fiskal paraardhës.
- g. Të thërras Mbledhje të Asamblesë jashtë radhës kur e sheh të nevojshme për marrje vendimesh që nuk janë kompetencë e tij.



Handwritten signatures and a circular stamp are present at the bottom of the page. The stamp is partially visible on the right side.

- h. Të nënshkruaj kontrata në emër dhe për llogari të Shoqërisë dhe të
- i. sigurojë realizimin e tyre.
- j. Të përfaqësoj Shoqërinë përpara të tretëve dhe në gjykata. Në raste të veçanta për këto probleme të delegojnë persona të tjerë.
- k. Të caktoj pagat e punonjësve në përputhje me kriteret dhe brenda kufijve të aprovuar nga Asambleja dhe kontratës së punës.
- l. Të vendos për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë e mbledhjes së Partnerëve.

MARREDHENIET E PUNËS

Neni 15

Shoqëria merr përsipër që të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore për të gjithë të punësuarit në Shoqëri, ndërsa këta të fundit janë të detyruar të pranojnë Statutin e Shoqërisë.

Neni 16

Të punësuarit në Shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas statutit për moszbatimin e detyrave të ngarkuara, si dhe për dëmet që ata i shkaktojnë Shoqërisë. Ata mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e të punësuarve me Shoqërinë synohen të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt do t'u paraqiten për zgjidhje Gjykatës shqiptare. Kur pala ankuese është person i huaj, mosmarrëveshjet që nuk zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen nga organi i përcaktuar në kontratën e punës.

Neni 18

Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon Shoqëria gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomike, përveç rasteve kur në kontratën e punës është përcaktuar ndryshe.

Ortakët e punonjësit nuk lejohen të jenë ortakë ose punonjës në Shoqëritë e tjera me aktivitet konkurrues në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për çdo shkelje në këtë drejtim përgjigjen për dëmet e shkaktuara dhe largohen nga Shoqëria.

Përjashtim bëhet vetëm kur Asambleja e Shoqërisë jep aprovim duke vendosur me të paktën $\frac{3}{4}$ e votave.

SEKRETI I PUNËS


Neni 19

Ortakët dhe të punësuarit janë të detyruar të ruajnë në çdo kohë sekretin e punës së Shoqërisë. Ky detyrim vazhdon edhe mbas largimit të tyre nga Shoqëria.

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Neni 20

Përfaqësimi i Shoqërisë Tregëtare „ * * RAPO'S RESORT HOTEL * * sh.p.k i përket Administratorit të Përgjithshëm të saj Z. Thanas Rapo. Ai ka të drejtë përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore, të caktojë e të pushojë avokatë për çështje në gjykim.



KONTROLLI I BRENDSHËM

Neni 21

Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar, me ose pa afat të caktuar, me mundësi rizgjedhjeje dhe largimi nga puna. Ekspertët kontabël kontrollojnë dhe garantojnë që llogaritë vjetore janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet dhe që japin pasqyrim besnik të rezultateve të operacioneve të vitit të kaluar financiar, të gjendjes financiare të trashëgimisë së Shoqërisë në fund të këtij viti financiar. Ata kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të Shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvlerësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 22

Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori miratohen nga Asambleja me mbi ½ e votave.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Me miratimin e llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve.

Fitimi që do të ndahet nëpërmjet ortakëve, përbëhet nga fitimi i vitit financiar pasi atij i janë zbritur taksat dhe tatimet e ndryshme, si dhe shumat e nevojshme për mbulimin e humbjeve të mbartura nga humbjet e mëparshme konform ligjit.

Neni 23

Pjesa e fitimit që nuk korrespondon me fitimet e realizuara realisht mund t'iu reklamohen ortakëve që i kanë marrë ato duke kërkuar kthimin brenda një afati prej tre vitesh nga data e shpërndarjes së fitimit.

Neni 24

Asambleja mund të vendosë që të shpërndahen shumat e rezervuara në fondet, duke treguar shprehimisht llojet e rezervës ku janë marrë këto shuma.

Neni 25


Në selinë e Shoqërisë mbahen dokumentacion i plotë i saj, dokumentat themelues të Shoqërisë, si dhe dokumentat normativë që rregullojnë marrëdhëniet brenda Shoqërisë, me gjithë dokumentat e kontabilitetit, për të bërë vetëkontrollin e Shoqërisë si dhe për kontrollet nga organet shtetërore të autorizuar, sipas ligjeve në fuqi.

Në selinë e Shoqërisë mbahen edhe protokolle të ndryshme dhe lista të personave që janë autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë.

Dokumentat si më sipër njihen mirë nga Administratori i Përgjithshëm dhe Ortakët e Shoqërisë, të cilat duhet t'iu bëhen mirë të njohura atyre nga ana e administratorëve të emëruar të Shoqërisë.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 26



Shpërbërja e Shoqërisë Tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, si në rast falimentimi, privimi i të drejtave për të ushtruar profesion tregëtar, forca madhore, në rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga dëshira e Asamblesë së Shoqërisë.

Në këto raste, Asambleja e Shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një ose më shumë likuidatorë.

Në rast likuidimi të Shoqërisë, emërtimi i saj do të priset nga shënimi "SHOQËRI NË LIKUIDIM E SIPËR".

Likuidatorët dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë shoqërore, përderisa t'iu dorëzohet personave përkatës fizikë dhe juridikë, duke likuiduar detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve, në radhë të parë.

Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar kontribuesve përkatës, likuiduesi i ndan kapitalet e mbetura në mes ortakëve, përpjestimisht me kuota që ata zotërojnë.

Në fund të procesit të likuidimit, Asambleja vendos bilancin përfundimtar financiar, aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesve dhe mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesve dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Mbase bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryhen formalitetet e likuidimit, Shoqëria çregjistrohet nga Regjistri Tregëtar i Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHMË Neni 27

Çdo ndryshim e plotësim Statuti nuk prek personalitetin juridik të Shoqërisë Tregëtare "RAPO'S RESORT HOTEL ,, shpk .
Neni 28

Ky Statut përpilohet në disa kopje, për t'iu shpërndarë organeve përkatëse :

- Gjykatës së Rrethit të Tiranës për të bërë veprimet në regjistrin tregtar dhe njohjen si person juridik të kësaj Shoqërie Tregtare.
- Sektorit të Tatimeve VLORE për të bërë regjistrimin e Shoqërisë si subjekt privat dhe marrjen e lejes së ushtrimit të veprimtarisë.
- Një kopje mbetet si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare ,,
- Statuti hyn në fuqi ditën e Shpalljes së tij, i firmosur rregullisht nga ortakët themelues të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE:

Jani Rapo
Rano Ryo

ARISTOTEL RAPO

NAROLON RAPO

Jonas Rapo